

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Instituti i Statistikave sot organizon konferencën për treguesit gjinorë “Burrat dhe Gratë në Shqipëri”. Publikimi “Burra dhe Gra në Shqipëri, 2017” vjen kësaj here para publikut me informacion më të plotë mbi statistikat gjinore në vendin tonë si dhe disa risi lidhur me to. Ndër këto risi, si më kryesoret mund të përmendim që në fillim ndryshimin në vetvete të emërtimeve nga “Femra dhe Meshkuj” në “Burra dhe Gra”. Pas disa konsultimesh me ekspertë të kësaj fushe, INSTAT bëri këtë ndryshim emërtimi siç e kanë bërë dhe institutet e tjera homologe, si dhe organizatat ndërkombëtare për të qenë koherent dhe i njehsuar me to. Në këtë publikim flitet me gjuhën e shifrave për burrat dhe gratë si rol që ata kanë në shoqëri dhe jo si përkatësi gjinore duke i ndarë në femra dhe meshkuj.

Botimi “Burra dhe Gra në Shqipëri” i këtij viti, përmban gamën më të madhe të statistikave gjinore në vend dhe kjo është risia kryesore e këtij publikimi përsa i përket shifrave. Panorama e statistikave gjinore do të jetë më e plotë dhe publiku do të ketë në dorë një nga botimet më të mira ndër vite.

Githashtu, për herë të parë është bërë një analizë e thelluar mbi hendekun gjinor në paga, i cili ka lindur si kërkesë e përdoruesëve për të parë në mënyrë analitike diferencën në paga midis burrave dhe grave.

Kapitujt e përfshirë në publikimin “Burra dhe Gra në Shqipëri, 2017”, përfshijnë fusha të ndryshme të të dhënave me bazë gjinore, të mbledhura si nga anketat e zhvilluara nga INSTAT ashtu edhe nga informacioni që disponojnë institucionet e tjera shtetërore në vend.

Ky libër, do të ofrojë një panoramë me bazë gjinore mbi **tregun e punës** ku janë pasqyruar tregues nga Anketa e Forcave të punës dhe të dhëna administrative nga Zyra Kombëtare e Punësimit. Po të vështrime statistikave të tregut të punës do të shohim që burrat janë më shumë prezent sesa gratë në tregun e punës duke pasqyruar pjesëmarrjen më aktive të tyre në tregun e punës, respektivisht 74,1 % dhe 59,3 %. Ndërkohë nga pikpamja e inaktivitetit 21,5 % e grave deklarojnë se janë inaktive në tregun e punës duke qenë se janë duke përmbushur detyrat shtëpiake, dhe vetëm 1 % e burrave e deklarojnë këtë si shkak inaktiviteti. Po të hedhim një vështrim të diferencës që kanë burrat dhe gratë në paga në Shqipëri vërejmë se hendeku gjinor është 6,3 % në favor të meshkujve që do të thotë se gratë paguhet mesatarisht sa 93,7 % të pagës së burrave. Ky tregues mund të duket i ulët në krahasim me vendet e tjera, por pjesëmarrja e ulët në tregun e punës për gratë si dhe niveli i ulët në përgjithësi i pagave ndikojnë në një hendek gjinor më të ulët. Kësisoj, të dhënat gjinore mbi tregun e punës duhet të jenë baza për ndërtimin e strategjive të punësimit sektorial nga politikëbërësit.

Statistikat e popullsisë, me afërisht 34 tregues gjinorë, do të paraqesin informacion për lindjet dhe vdekjet, martesat dhe divorcet. Nga shifrat e popullsisë shohim disa të dhëna interesante nga ku mund të veçojmë se gratë jetojnë mesatarisht 3 vite më shumë sesa burrat. Jetëgjatësia mesatare në vitin 2016, llogaritet 77 vite për burrat dhe 80 vite për gratë.

Tek **statistikat e martesave** vërejmë se moshë mesatare e martesës për gratë është 25,1 vjeç dhe 30,4 për burrat, duke e krahasuar me 10 vite më parë, kjo moshë ka ardhur në rritje për të dy gjinitë, por duke ruajtur një diferencë prej 5 vitesh.

Statistikat mbi arsimin, si indeksi i barazisë gjinore sipas niveleve të arsimit apo nxënësit me aftësi të kufizuar sipas gjinisë janë tjetër risi në këtë publikim. Në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar djemtë kanë një pjesmarrje më të lartë me rreth 53 %, ndërkohë ky raport përmbysset në nivelin universitar ku vajzat përbëjnë 58 % të studentëve gjithsej. Kjo vërtetohet dhe nga Indeksi i Barazisë gjinore në shkolla, ku vetëm në ciklin e arsimit të lartë është mbi 1.5 duke konfirmuar pjesmarrjen më të lartë të vajzave në këtë nivel.

Nga ana tjetër, në këtë publikim siç është bërë traditë prej disa vitesh, përfshihen informacione nga bizneset për gratë në **vendim-marrje**.

Vihet re që në vitin 2016 përqindja e ndërmarrjeve aktive të drejtuara nga gratë është 26,8 % dhe pjesëmarrja e grave si pronare apo administratore në ndërmarrjet e reja është 24 %. Përfaqësimin më të lartë të drejtimit të ndërmarrjeve gratë e kanë për ndërmarrjet me më pak se 10 punonjës, ndërkohë me ndërmarrjet me mbi 20 punonjës përfaqësimi i tyre si pronare është nën 20 %. Gratë janë më shumë si drejtuese në ndërmarrjet e prodhimit të shërbimeve me 33,3 % në krahasim me ndërmarrjet e prodhimit të mirave me 11,7 %.

Por, statistikat gjinore janë vetëm hapi i parë në përcaktimin e politikave më të mira për burrat dhe gratë në shoqëri: hapi i ardhshëm është të kuptojmë pse ndodhin dallime midis tyre dhe më pas të synojnë përmirësimin e politikave gjinore në vend.

Pra, siç shihet nga treguesit e pakët që përmenda më lart, nga moria e të dhënave gjinore që gjenden në këtë publikim, vihen re dallime gjinore në tregun e punës, në vendimmarrje e më gjerë, ndaj të dhënat e këtij botimi do t'u shërbejnë politikbërësve, botës akademike, shoqërisë civile dhe përdoruesve të ndryshëm, të analizojnë më gjerë kontekstin e barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare.

Për ta mbyllur fjalën time, dua të falenderoj Entitetin e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), për partneritetin afatgjatë me INSTAT për fuqizimin e statistikave sociale. Gjithashtu falenderoj të gjithë kontribuesit nga institucionet e tjera që kanë furnizuar INSTAT me të dhëna gjinore për ta bërë këtë botim akoma dhe më të plotë nga vitete e tjera. Një falenderim i veçantë i dedikohet të gjithë stafit të INSTAT për realizimin me sukses të këtij publikimi.